

Vendim nr. 126, datë 23.04.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 23.04.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (A) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ARMINDA JAUPI, VILFRID SHYTI**, përfaqësuar nga avokati Erjon Syziu, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3580, datë 16.10.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Procesi gjyqësor, i cili ka përfunduar me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, të kundërshtuar nga kërkuessit, është nisur nga shtetasit S.Xh. dhe P.J., duke pasur si

objekt të kërkesëpadsisë pavlefshmërinë e aktit administrativ nr. 194, datë 26.06.2009 (*vendimi nr. 194/2009*) të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë (AKKPT). Gjatë gjyqimit të çështjes kërkuesit kanë bërë kërkesë për t'u paraqitur si ndërhyrës kryesorë, duke kërkuar detyrimin e shtetasve S.Xh., B.Xh. dhe P.J. t'i njohin pronarë ata (kërkuesit) për pronën e kthyer sipas vendimit nr. 194/2009 të AKKPT-së.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6940, datë 16.06.2014, ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadsisë së paditësve S.Xh. dhe P.J. Konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit nr. 194/2009 të AKKPT-së. Rrëzimin e kërkesëpadsisë së ndërhyrësve kryesorë Arminda Jakupi dhe Vilfrid Shyti.”. Kundër këtij vendimi kanë bërë ankim kërkuesit dhe Agjencia e Trajtimin të Pronës (ATP).

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1120, datë 11.05.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6940, datë 16.06.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndaj këtij vendimi rezulton se ka bërë rekurs vetëm ATP-ja, ndërsa kërkuesit nuk rezultojnë të kenë paraqitur rekurs.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3580, datë 16.10.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga ATP-ja, pasi nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

5. Në datën 10.02.2026 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

II

Pretendimet e kërkuesve

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se:

6.1. Është cenuar *e drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë ka zhvilluar një procedurë gjyqësore në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe asaj të Gjykatës. Gjykata e Lartë dhe gjykatat e faktit nuk i kanë garantuar palës humbëse aksesin në drejtësi. Gjykata e Lartë duhet të kishte marrë në analizë praktikën gjyqësore, kushtet ligjore dhe parashikimet kushtetuese se cili ishte qëllimi i kërkesëpadsisë objekt shqyrtimi dhe i kërkesëpadsisë së nisur nga Avokatura e Shtetit, për kundërshtimin e vendimit nr. 194/2009 të AKKPT-së. Gjykatat nuk kanë përcaktuar kompetencën funksionale, për të parë nëse çështja e shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit nr. 194/2009 bënte pjesë në juridiksionin gjyqësor ose në atë administrativ. Kjo shkelje nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë.

- 6.2. Është cenuar *parimi i barazisë së armëve*, pasi kërkuessit janë gjendur në pamundësi për të mbrojtur të drejtat që rrjedhin nga vendimi nr. 194/2009 i AKKPT-së, duke mos arritur të mbronin pronën e tyre. Ky fakt nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë. Gjykatat nuk kanë vlerësuar faktin se prona për të cilën është pranuar kërkesëpapia nuk bënte pjesë në sipërfaqen e pronës që ishte trajtuar më herët prej tyre në favor të paditësve S.Xh. dhe P.J. Gjykata e Lartë nuk rezulton të jetë shprehur për kërkesën e kërkuessve për administrimin e provës shkencore shtesë.
- 6.3. Gjykatat nuk kanë pasur parasysh natyrën e vendimeve të AKKPT-së, si vendime *quasi gjyqësore*. Vlera e këtyre vendimeve qëndron në faktin se ato mbyllin konfliktin juridik në nivelin administrativ. Nga niveli doktrinar duhet të shqyrtohet qasja që Gjykata duhet të ketë në lidhje me vlerësimin e këtyre vendimeve në raport me zbatimin korrekt të ligjit procedural dhe material. Gjykatat e aktit dhe Gjykata e Lartë kanë drejtuar vijueshmërinë e gjykimit të çështjes, duke trajtuar vendimin nr. 194/2009 jo si një akt juridik me vlerë *quasi gjyqësore*, por si një akt të zakonshëm administrativ, duke lidhur shkaqet e pavlefshmërisë së tij me elementet e pavlefshmërisë së aktit administrativ.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuessve

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të

çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, Kolegji evidenton se mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

9. Një nga kriteret paraprake për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual është ai i *shterimit të mjeteve juridike efektive*. Në lidhje me këtë kriter, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ai nënkupton në aspektin formal që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës, ndërsa në aspektin substancial që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha shkallët e gjykimit, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga ATP-ja, ndërkohë që kërkuesit nuk kanë paraqitur rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit. Në ankimin kushtetues individual kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument në lidhje me këtë fakt, pa arritur të tregojnë kështu efektivitetin e këtij mjeti juridik (rekursit). Ndërkohë, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë, i kundërshtuar nga kërkuesit, nuk e ka ndryshuar vendimin e gjykatës së apelit, i cili nuk ka qenë i favorshëm për ta (kërkuesit), duke pranuar kërkesëpadinë e shtetasve S.Xh. dhe P.J. për konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit nr. 194/2009 të AKKPT-së dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuesve, si dhe duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar në të njëjtën mënyrë. Në këtë drejtim konsiderohet se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohen Gjykatës. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i tyre nuk mund të merret në shqyrtim. Për më tepër, referuar edhe thelbit të pretendimeve të kërkuesve, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit, të cilat, si të tilla, bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe jo në juridiksionin kushtetues.

11. Në kushtet kur kërkuesit nuk plotësojnë një nga kriteret për legjitimitimin e tyre, konkretisht atë të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1,

shkronja “f”, të Kushtetutës, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

12. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesve nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.